



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.100, Datë 24.06.2020

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 27, DATË 30.01.2018 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC LLËNGË” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LLËNGA 1” ME FUQI 1730 KW, HEC “LLËNGA 2” ME FUQI 300 KW DHE HEC “LLËNGA 3” ME FUQI 1500 KW, ME FUQI TOTALE 3530 KW”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 3 dhe 113 të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenit 8 dhe 10 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.06.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.75/5 Prot, datë 17.06.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 27, datë 30.01.2018, mbi licencimin e shoqërisë “Hec Llëngë” shpk. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Hec Llëngë” shpk, është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.01.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Llënga 1” me fuqi 1730 KW, Hec “Llënga 2” me fuqi 300 KW, Hec “Llënga 3” me fuqi 1500 KW, me fuqi totale 3530 KW, me kusht që përpara fillimit të operimit të depozitonte në ERE, miratimin përfundimtar të lejes së ujit para vënies në operim të veprës.
- Rezulton se shoqëria “Hec Llëngë” sh.p.k., është futur në operim pa bërë me dije ERE-n për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit Nr. 27/2018.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 318/5 Prot, datë 04.06.2020, shoqëria “Hec Llëngë” sh.p.k., ka depozituar në ERE “Leje për përdorim të burimit ujqor” nr. 82/1 Prot, datë 05.11.2018, “Leje për përdorim të burimit ujqor” nr. 83/1 prot, datë 05.11.2018, si dhe “Leje për përdorim të burimit ujqor” nr. 84/1 Prot, datë 05.11.2018, të lëshuara nga Këshilli i Basenit Ujqor -Shkumbin, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 27/2018.
- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., së fundi ka bërë me dije ERE-n që ka filluar procedurën për përfundimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Hec Llëngë” shpk, sipas informacionit të bërë me dije nga ERE se nuk rezulton të jenë plotësuar kushtet e parashikuara në vendimin e bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.01.2018

- ERE i ka kthyer përgjigje “FTL” sh.a., duke e informuar se po shqyrton dokumentacionin e depozituar nga Shoqëria dhe se do të njoftohet në vijim mbi vendimmarrjen e ERE-s.
- Rezulton se Shoqëria “Hec Llëngë” sh.p.k., ka depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar si kusht i pikës 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.01.2018, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në vendimin e licencimit.
- Depozitimi i miratimit përfundimtar të lejes së ujit pas fillimit të operimit nuk afekton detyrimet që lindin nga kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike të lidhur mes shoqërisë “Hec Llëngë” shpk. dhe “OSHEE” sha., duke vlerësuar kohën e dhënies së kësaj leje.
- Kontrata është nënshkruar dhe operimi i veprës ka filluar, pas paisjes me leje sic edhe kërkon pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.01.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Hec Llëngë” shpk në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Llënga 1” me fuqi 1730 KW, Hec “Llënga 2” me fuqi 300 KW, Hec “Llënga 3” me fuqi 1500 KW, me fuqi totale 3530 KW,

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.01.2018 “Mbi licencimin e Shoqërisë “Hec Llëngë” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Llënga 1” me fuqi 1730 kW, Hec “Llënga 2” me fuqi 300 kW dhe Hec “Llënga 3” me fuqi 1500 kW, me fuqi totale 3530 kW”.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë shoqërinë e licencuar dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI